



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1060/2 Prot.

Vlorë, më 23. 06. 2021

VENDIM

Nr. 31, datë 23. 06. 2021

PËR

**MIRATIMIN RREGULLORES SË QENDRËS KËRKIMORE SHKENCORE TË
FAKULTETIT TË EKONOMISË NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 19, pika 1, shkronja dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Senati Akademik në mbledhjen e datës 23. 06. 2021,

VENDOSI

1. Të miratojë Rregulloren e Qendrës Kërkimore Shkencore të Fakultetit të Ekonomisë (sipas materialit bashkëlidhur)
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I EKONOMISË
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE

RREGULLORE

E QENDRËS KËRKIMORE SHKENCORE E FAKULTETIT TË EKONOMISË,
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORË

Punoi:

Dr. Lorena (Alikaj) Serjanaj

Qershor, 2021



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I EKONOMISË
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE

PËRMBAJTJA

	Faqe
KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	4
Neni 1 Baza ligjore e Rregullores	4
Neni 2 Statusi juridik	4
Neni 3 Përkufizime	4
KREU II OBJEKTI I VEPRIMTARISË	5
Neni 4 Qëllimi i rregullores së QKSH-FE	5
Neni 5 Misioni i QKSH-FE	5
Neni 6 Detyrat kryesore të QKSH-FE	6
Neni 7 Fushat e studimit	7
Neni 8 Aktivitetet e QKSH-FE	7
Neni 9 Kualifikimi i Stafit	8
Neni 10 Infrastruktura Kërkimore-Shkencore	8
KREU III STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE DREJTUESE E QKSH-FE	8
Neni 11 Përbërja dhe struktura e QKSH-FE	9
Neni 12 Drejtuesi i Qendrës	9
Neni 13 Tagrat e përfaqësimit	10
Neni 14 Kompetencat administrative të Drejtuesit të QKSH-FE	10
Neni 15 Kompetencat kërkimore të Drejtuesit të QKSH-FE	10
Neni 16 Funkcionet e Stafit të QKSH-FE	11
Neni 17 Rregullat e punësimit	12
Neni 18 Etika në punë	12
KREU IV BURIMET E FINANCIMIT	12
Neni 19 Viti financiar	13
Neni 20 Burimet bazë të financimit	13
KREU V ETIKA NË VERPIMTARINË KËRKIMORE-SHKENCORE	13
Neni 21 Veprimtaria Kërkimore-Shkencore	13
Neni 22 Publikimi i rezultateve të veprimtarisë kërkimore dhe autorësia	14
KREU VI DISPOZITA TË VECANTA	14
Neni 23 Vlerësimi i cilësisë	14
Neni 24 Analiza vjetore e veprimtarisë së QKSH-FE	14



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I EKONOMISË
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE

Neni 25

Vlefshmëria e rregullores

15



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I EKONOMISË
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Baza ligjore e Rregullores

Rregullorja e Qendrës Kërkimore Shkencore e Fakultetit Ekonomik është formuluar duke u mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", përkatësisht në nenin 26 "Qendrat Kërkimore-Shkencore", në nenin 11 në Statut dhe Rregulloren e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, dhe në gjithë legjislacionin tjetër në fuqi.

Neni 2
Statusi juridik

Në përputhje me nenin 26 të Ligjit Nr.80/ 2015 të Arsimit të Lartë, bazuar në vendimin Nr. 10, Dt. 27.01.2017 të Senatit Akademik të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë "Për miratimin e strukturës organizative dhe organigramës së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë" në çdo Fakultet të Universitetit u hapën Qendrat Kërkimore Shkencore për të përmbushur më së miri misionin dhe qëllimin e UV-së. Qendra Kërkimore Shkencore e Fakultetit të Ekonomisë do të kryejë studime në fushë e ekonomisë me fokus të veçantë rreth sipërmarrjes dhe inovacionit, për të përmbushur objektivat e Planit Strategjik të Universitetit, Fakultetit dhe Departamenteve. Nga këtu e në vijim emërtimi i shkurtuar i Qendrës Kërkimore të Fakultetit të Ekonomisë është: "QKSH-FE". Selia e saj ndodhet në Vlorë në adresën: Fakulteti i Ekonomisë, Godina A, Sheshi Pavarësia, Skelë-Vlorë. Adresa elektronike: src-fe@univlora.edu.al

Neni 3
Përkufizime

Për qëllim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
"QKSH-FE" nënkupton Qendrën Kërkimore Shkencore të Fakultetit të Ekonomisë.
"Strukturë Organizative" nënkupton stafin akademik dhe ndihmës akademik të QKSH-FE, specialistin e QKSH-FE, studentët dhe grupet e tjera të interesit.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I EKONOMISË
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE

KREU II
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 4
Qëllimi i rregullores së QKSH-FE

Rregullorja e QKSH-FE është dokumenti bazë që rregullon veprimtarinë e Qendrës Kërkimore Shkencore në Fakultetin e Ekonomisë dhe e shtrin veprimin e saj brenda Qendrës Kërkimore Shkencore, personelin akademik, personelin ndihmës akademik, studentët e Fakultetit të Ekonomisë dhe bashkëpunëtorët e institucionit. Kjo rregullore është në përputhje dhe mbështet veprimtarinë kërkimore-shkencore të Fakultetit të Ekonomisë dhe të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Në këtë rregullore përcaktohet qartë misioni i veprimtarisë së QKSH-FE, rregullat normative të organizimit të studimeve dhe projekteve në fushën kërkimore-shkencore, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, të personelit akademik dhe administrativ, të studentëve, të bashkëpunëtorëve, rregullat për pranimin e projekteve, për kërkimin, për vlerësimin, për publikime, për rekrutimin e personelit si dhe parashikon masat në rastin e shkeljes së rregullores.

Neni 5
Misioni i QKSH-FE

Misioni i QKSH-FE është të krijoj një mjedis të përshtatshëm, motivues dhe kreativ i cili do të nxisë, zhvillojë dhe mbështeti të menduarin e sipërmarrjes dhe inovativ jo vetëm në Fakultet por në gjithë Universitetin dhe komunitetin në tërësi. Qendra QKSH-FE do të mbështesë studentët, industrinë/biznesin dhe komunitetin për të zhvilluar idetë e biznesit dhe për t'i shndërruar ato në projekte të zbatueshme. Gërshetimi i ideve inovative me zbulimet kërkimore nga kërkuesit shkencor do të nxisë sipërmarrjen në vend duke përmirësuar cilësinë e jetës, duke nxitur zhvillimin ekonomik dhe duke përmirësuar konkurrueshmërinë e sektorit privat në tregun global.

Qëllimi kryesor i QKSH-FE është promovimi dhe mbështetja e kërkimit shkencor mbi sipërmarrjen dhe inovacionin në UV.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I EKONOMISË
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE

Objektivat e QKSH-FE-së janë:

- të nxisë një kulturë të sipërmarrjes inovative brenda Fakultetit që do të ndihmojë studentët dhe pedagogët të zhvillojnë mendësinë sipërmarrëse për gjenerimin e zgjidhjeve inovative për problemet e botës reale;
- të zhvillojë aftësitë dhe të ndërtojë kapacitetet për të zhvilluar kërkime ndërdisiplinare në fushën e ekonomisë, biznesit, turizmit, inovacionit dhe atë të sipërmarrjes në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare, nëpërmjet ofrimit të programe të ndryshme të trajnimit;
- të stimulojë aktivitetet kërkimore të stafit dhe të studentëve që çojnë në zhvillimin e njohurive të përparuara, teknologjive të reja dhe praktikave më të mira të përparuara në fushën ekonomike;
- të propozojë programe të reja rreth ekonomisë, sipërmarrjes dhe inovacionit që do të rrisin reputacionin e Fakultetit dhe Universitetit;
- të krijojë infrastrukturën e duhur për të përkthyer idete inovatore të stafit dhe studentëve që kanë një impakt ekonomik dhe social;
- të forcojë lidhjet dhe partneritetet brenda UV-së me Qendrat e tjera kërkimore të Universitetit;
- të forcojë lidhjet dhe partneritetet me institucionet qeveritare, joqeveritare, sektorin privat (industrinë/biznesin) dhe komunitetin;
- të kërkojë fonde financiare nga burime të jashtme për projekte dhe programe kërkimore në lidhje me fushën ekonomike dhe fusha të tjera që ka interes;
- të japë sugjerime për të shtuar ose për të ndryshuar kurrikulën dhe programimin për studentët në lidhje me inovacionin dhe sipërmarrjen;
- të kontribuojë në krijimin e një ekosistemi të qëndrueshëm të sipërmarrjes dhe inovacionit në rajonin e Vlorës.

Neni 6

Detyrat kryesore të QKSH-FE

Detyrat kryesore të QKSH-FE janë:

- kryen aktivitete kërkimore;
- kryen dhe zbaton projekte kërkimore shkencore;



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I EKONOMISË
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE

- merr pjesë në zhvillimin e iniciativave të avancuara të trajnimit, përfshirë dhe programet e doktoratës;
- krijon dhe pasuron në mënyrë të vazhdueshme një databazë mbi të dhënat firmave/industrisë dhe dokumentacionit të sistemit të QKSH-FE-së;
- publikon dhe shpërndan rezultatet e punës kërkimore të kryer;
- promovon dhe komercializon rezultatet e kërkimit;
- promovon bashkëpunimin ndërinstitucional në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare;
- kryhen studimeve, vlerësimeve dhe ofron këshillim teknike dhe ekspertizë;
- kryhen aktivitete në terren;
- inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në aktivitetet kërkimore shkencore;
- nxit dhe zhvillon trajnimin profesional të stafit akademik, ndihmës akademik, dhe të studentëve;
- jep bursa dhe çmime për të mbështetur veprimet që lidhen me arsimin, kërkimin dhe inovacionin;
- kryen çdo veprimtari tjetër si pjesë e misionit të saj.

Neni 7
Fushat e studimit

QKSH-FE ofron disa fusha studimi si më poshtë:

- Sipërmarrja, Inovacioni dhe Ndryshimet teknologjike.
- Analizat e Biznesit, Tregtia Elektronike, Siguria e Informacionit.
- Turizmi, Marketingu dhe Zhvillimi Rajonal.
- Tregjet, institucionet dhe ligjet financiare.
- Mikrofinanca dhe kontabiliteti në ekonomitë në tranzicion.
- Kapitali human dhe rritja ekonomike.
- Metodatat sasiore/cilesore dhe modelimi ekonomik.
- Kultura dhe krijimtaria.
- Fusha të tjera që u interesojnë antarëve të Fakultetit dhe Universitetit që lidhen me realizimin e qëllimit të saj.

Neni 8



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I EKONOMISË
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE

Aktivitetet e QKSH-FE

Në kuadër të veprimtarisë kërkimore-shkencore QKSH-FE kryhen këto veprimtari:

- kryen hulumtime dhe studime mbi çështje ekonomike dhe financiare qofshin ato kombëtare, rajonale apo ndërkombëtare;
- menaxhon punët për hartimin dhe zbatimin e projekteve kërkimore-shkencore si dhe kryen propozimet konkrete për përpilimin e projekt-buxhetit për financimin e punimeve shkencore;
- mban konferenca, workshope, seminare për të promovuar sipërmarrjen, inovacionin, punët kërkimore etj.;
- menaxhon seminare trajnimi për studentë, ekonomistë, financues, akademikë, nëpunës civilë, OJQ, politikëbërës dhe komunitetin e biznesit;
- organizon leksione të hapura ku do të ftohen figura: si ekonomistë, analistë teknikë dhe financiarë, student si dhe akademikë e të tjerë;
- ofron konsultimeve dhe asistencë teknike me sektorin financiar, turizmit si dhe me sektorin e biznesit për çështje specifike ekonomike dhe financiare;
- ofron këshillim për sektorin publik/privat për financimin, vendimet e buxhetimit, menaxhim e asetëve, analizë të dhënash, analiza dhe kërkim tregu, etj.;
- merr pjesë në rrjete kombëtare e ndërkombtare;
- publikon dokumente politikash, broshura dhe libra për të ndihmuar studentët, studiuesit dhe politikëbërësit të kuptojnë më shumë çështje që shqetësojnë Vlorë, Shqipërinë, Vendet e Rajonit dhe me gjerë.

Neni 9

Kualifikimi i Stafit

Kualifikimi i stafit, sidomos kuadri i ri, është detyrë parësore dhe e vazhdueshme e QKSH-FE, për të përballuar me cilësi qëllimin për kërkim dhe zhvillim të Qendrës Kërkimore Shkencore të FE-së.

Neni 10

Infrastruktura Kërkimore-Shkencore



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I EKONOMISË
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE

Infrastruktura kërkimore-shkencore përfshin kryesisht: objektet, paisjet dhe shërbimet e nevojshme për veprimtarinë kërkimore-shkencore, si laboratorët kërkimorë-shkencorë, bibliotekat shkencore, shërbimet informative shkencore, botimet shkencore dhe fushat e bashkëpunimit etj.

KREU III
STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE DREJTUESE E QKSH-FE

Neni 11

Përbërja dhe struktura e QKSH-FE-së

Në përputhje me nenin 26 të Ligjit Nr.80/ 2015 të Arsimit të Lartë, bazuar në Vendimin Nr. 10, Dt. 27.01.2017 të Senatit Akademik të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë "Për miratimin e strukturës organizative dhe organigramës së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë" në përbërje të Qendrës Kërkimore Shkencore të Fakultetit të Ekonomisë janë:

- *Përgjegjësi i Qendrës Kërkimore Shkencore*
- *Një Specialistë i Qendrës Kërkimore Shkencore*
- *Pjesëmarrje aktive vullnetare e studentëve, stafit akademike dhe administrativ të Fakultetit dhe Universitetit.*

Neni 12

Drejtuesi i Qendrës

Drejtuesi i Qendrës është autoriteti drejtues i QKSH-FE ne Fakultetin Ekonomik. Ai është personel akademik dhe gëzon të paktën kategorinë Doktor i Shkencave. Ai përfaqëson komunitetin shkencor të Fakultetit të Ekonomisë në Organizmat Kombëtarë dhe Ndërkombëtarë të Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit Teknologjik brenda ose jashtë vendit.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I EKONOMISË
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE

Neni 13

Tagrat e përfaqësimit

Qendra Kërkimore Shkencore në marrëdhënie me të tretët, përfaqësohet nga Drejtuesi i Qendrës dhe Dekani, në mungesë të tij, nga njëri prej dy përfaqësuesve, i cili autorizohet nga Titullari.

Neni 14

Kompetencat administrative të Drejtuesit të QKSH-FE

Drejtuesi i QKSH-FE është përgjegjës për sigurimin e udhëheqjes administrative, e cila përfshin:

- drejtimin strategjik të QKSH-FE-së, i cili siguron që objektivat e Qendrës janë në përputhje me objektivat e Planit Strategjik të Universitetit;
- është përgjegjës për hartimin e Rregullores së Brendshme të veprimtarisë së Qendrës dhe ia paraqet për miratim Dekanit;
- mbikëqyrjen e kryerjes së detyrave administrative të Qendrës kërkimore duke përfshirë personelin mbikëqyrës, menaxhimin financiar dhe operacionet;
- përgatitjen e agendës kërkimore dhe studimore, aktiviteteve të Qendrës, si dhe hartimin e planit buxhetor vjetor të saj;
- ndjekjen e qëllimeve të barazisë së Fakultetit/Universitetit në operacionet e kërkimore të qendrës;
- menaxhimin e planit kërkimor në mënyrë efektive dhe efikase, duke siguruar zbatimin e të gjithave standardeve të kërimit dhe sjelljes etike;
- menaxhimin e hapësirave të mundshme të bashkëpunimit të bashkëpunimit qendrës kërkimore autoritetet universitare me të përshtatshme;
- përfaqësimin e interesave të Qendrës Kërkimore brenda vendit me akademikë dhe administruesit e vjetër;
- rritjen e reputacionit të Qendrës Kërkimore dhe universitetit nga
- ndërmarrja e kërimit cilësor dhe komunikimin e këtij kërkimi në shoqëri;
- inkurajimin dhe mbështetjen e mbledhjes së fondeve për kërkime të kryera nga qendra kërkimore, si psh.: institucionet qeveritare, sektori privat, OJQ/OJF vendase ose të huaja, fondacionet dhe donaterët, etj.

Neni 15

Kompetencat kërkimore të Drejtuesit të QKSH-FE



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I EKONOMISË
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE

Drejtuesi i Qendrës Kërkimore është përgjegjës për sigurimin e udhëheqjes kërkimore, e cila përfshin:

- promovimin dhe lehtësimin e kërkimit shkencor ndërdisiplinar, duke përfshirë bashkëpunimin në fushat që lidhen me qëllimet e fakultetit/ universitetit;
- zhvillimin e rrjeteve midis Qendrës Kërkimore dhe kërkuesve në terren në sektorët publik dhe privat, në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- duke vepruar si lidhje midis Fakultetit/Universitetit dhe komunitetit në lidhje me iniciativat kërkimore me përfitim reciprok;
- duke vepruar si lidhje midis Fakultetit/Universitetit me industrinë në për të zhvilluar partneritete dhe kërkime bashkëpunuese;
- transferimin e njohurive në shoqëri përmes shtrirjes në terren (p.sh. kërkime bashkëpunuese; seminare; workshope; leksione; faqet e internetit; botime) dhe, kur është e zbatueshme, përmes transferimit të teknologjisë (p.sh. kërkime bashkëpunuese; punë me kontratë; dhe komercializimi i pronës intelektuale);
- zhvillimin e lidhjeve të forta me departamentet dhe njësitë e duhura akademike dhe duke shtuar vlerë për departamentet e Fakultetit/Universitetit përmes:
 - ✓ ndihmesës së studentëve për zhvillimin e karrierës dhe mbi mundësitë e rekrutimit të tyre nga sektori privat;
 - ✓ ndihmës në përshtatjen dhe avancimin e kurrikulës;
 - ✓ ndihmës në ofrimin e seminare dhe workshopeve;
 - ✓ sigurimin e trajnimit dhe mentorimit të kërkimit ndërdisiplinor për studimet universitare ndaj studentëve, studentëve të diplomuar dhe stafit akademik;
 - ✓ komunikimit të rregullt të aktiviteteve të Qendrës Kërkimore dhe çdo aktiviteti tjetër sipas nevojave të përfshirjes së Fakultetit dhe studentëve.

Neni 16

Funksionet e Stafit të QKSH-FE

Funksionet kryesore të Stafit të QKSH-FE-së janë:

- të kërkojë nga autoritetet dhe organet drejtuese të Universitetit, respektimin e të gjitha të drejtave që burojnë nga Kodi i Punës dhe Ligji për Arsimin e Lartë;



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I EKONOMISË
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE

- të kryejë me përgjegjësi detyrën e ngarkuar duke vënë në shërbim aftësitë profesionale dhe intelektuale;
- të respektojë detyrat e ngarkuara nga drejtuesi i qendrës;
- të bëjë përpjekje maksimale për rritjen e kompetencave që kërkon vendi i punës;
- të respektojë me përgjegjësi disiplinën në punë;
- të mirëmbajë me përgjegjësi bazën materiale të qendrës;
- të ruajë bazën materiale që ka në ngarkim;
- të ruajë sekretin profesional, të mos japë të dhëna lidhur me detyrën që kryen pa qenë i autorizuar nga autoriteti drejtues përkatës;
- të zbatojë udhëzimet që dalin si domosdoshmëri gjatë realizimit të detyrës së ngarkuar;
- përveç detyrave kryesore të përcaktuara në rregulloret përkatëse, të realizojë edhe detyra të tjera në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi apo urdhrave të drejtuesit përkatës;
- të zbatojë çdo urdhër të posaçëm të drejtuesit përkatës, për situata të veçanta, emergjente apo ngjarje të rëndësishme në institucion.

Neni 17
Rregullat e punësimit

Procedurat e emërimit të personelit dhe kriteret e marrjes në punë të personelit të Qendrës përcaktohen në bazë të statutit të Universitetit.

Neni 18
Etika në punë

Në kryerjen e funksioneve të tij, nëpunësi i Qendrës duhet të respektojë rregullat e etikës në përputhje me Ligjin.Nr.9131 datë 08.09.2003 "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike".

KREU IV
BURIMET E FINANCIMIT



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I EKONOMISË
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE

Neni 19
Viti financiar

Viti financiar i Qendrës QKSH-FE fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.
Për çdo vit financiar hartohet bilanci ekonomik-financiar, i cili vlerësohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 20
Burimet bazë të financimit

Burim bazë të financimit të QKSH-FE-së janë:

- Buxheti i Shtetit;
- të ardhurat e përfituara nga shërbimet e kryera si: veprimtaritë kërkimore-shkencore (projektet kombëtare dhe ndërkombëtare), konsulencat, trajnimet, seminarët trajnuese.
- të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta;
- donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi;

KREU V
ETIKA NË VERPIMTARINË KËRKIMORE-SHKENCORE

Neni 21
Veprimtaria Kërkimore-Shkencore

Veprimtaria Kërkimore Shkencore në UV mbështetet mbi "*Rregulloren e etikës rreth veprimtarisë kërkimore shkencore dhe botuese*" të miratuar me vendim Nr. 68, datë 13.06.2017 nga Senati Akademik. Kërkimi shkencor efektiv synon të:

- nxisë veprimtarinë kërkimore efektive;
- nxisë ndërgjegjësimin për të gjitha aktet ligjore e nënligjore të kërkimit shkencor;
- hartojë dokumente, që përcaktojnë qartë politikat dhe procedurat e bazuara në këtë rregullore;



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I EKONOMISË
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE

- nxisë vazhdimisht bashkëpunimin e ndërsjellë midis kërkuesve nëpërmjet shkëmbimit të hapur të ideve dhe respektimit të lirisë së shprehjes;
- ruajtë një klimë që nxit përgjegjshmëri dhe etikën në kërkim.

Neni 22

Publikimi i Rezultateve të Veprimtarisë Kërkimore dhe autorësia

Veprimtaria kërkimore, ka për qëllim prodhimin, shtimin dhe përhapjen e njohurive kërkimore për publikun e gjerë. Publikimi i rezultateve të veprimtarisë kërkimore, bëhet në forma të ndryshme: revista shkencore brenda dhe jashtë vendit, buletine me përmbledhje të referimeve, kumtesave të mbajtura në kuadër të një veprimtarie shkencore (simpozium, konferencë, kongres), monografi etj. QKSH-FE do të publikojë online rezultatet e veprimtarisë kërkimore në faqen e saj zyrtare dhe në faqen zyrtare të Universitetit. Kërkuesit shkencor që kanë kyer studimin e tyre në bashkëpunim me QKSH-FE-në dhe e kanë publikuar/referuar punimin e tyre brenda ose jashtë vendit janë të detyruar të vendosin QKSH-FE-në si përkatësi.

KREU VI
DISPOZITA TË VEÇANTA

Neni 23

Vlerësimi i cilësisë

Vlerësimi i cilësisë së veprimtarisë kërkimore-shkencore të Qendrës Kërkimore Shkencore do të kryhet nga Komisioni i Përhershëm në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, struktura dhe funksionimi i të cilave përcaktohen në statutin dhe rregulloren e Universitetit.

Neni 24

Analiza vjetore e veprimtarisë së QKSH-FE

Në fillim të çdo viti akademik Qendra vendos qëllimin dhe objektivat dhe në fund të çdo viti akademik përgatitet një raport vjetor mbi punën e kryer.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I EKONOMISË
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE

Neni 25

Vlefshmëria e rregullores

Kjo rregullore pasi është diskutuar nga stafi akademik dhe Dekanati, firmoset nga Drejtuesi i QKSH-FE-së dhe i dërgohet Dekanit, i cili ja përcejell për miratim Senatit. Rregullorja hyn në fuqi pas miratimit prej Kryetarit të Senatit.